



Lajmet e Fundit:Shkodër – Ndalohe

1 shtetas

⏮ ⏪ ⏩ ⏭



04/07/2022

Gjiroka

stër – Mbante në ambientin që kishte në përdorim, armë zjarri dhe municion luftarak, shpallet në kërkim 41-vjeçari

Gjiroka

stër / Goditet edhe një rast i armëmbajtjes pa leje.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale, arma e zjarrit automatik dhe një sasi fishekësh.

Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas mbante armë zjarri, shërbimet e Komisar

ariatit të Policisë Gjiroka

stër identifikuan dhe shpallën në kërkim shtetasin H. M., 41 vjeç, banues në fshatin Kolonjë, Gjiroka

stër, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes

e dhe municionit”.

Ky shtetas u shpall në kërkim pasi, gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Policisë, në një ambient që kishte në përdorim, në fshatin Apsallë, Dropull, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri automatik dhe një sasi fishekësh.

Vijon puna intensive nga ana e strukturave të Policisë, për kapjen dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të 41-vjeçarit.

Materiale procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjiroka

stër, për veprime të mëtejshme.

WhatsApp ShareFacebook ShareTwitter ShareLinkedIn ShareEmail

◀ DVP Dibër – Arrestohen në flagrancë 3 shtetas, si dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë, për vepra të ndryshme penale

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Kantieri” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent